



ÇËSHTJA E
SUKCESIONIT TË SHTETEVE NË
DRITË TË 'FINALES SË MADHE' EVENTUALE
NDËRMJET
KOSOVËS DHE SERBISË





Sheshi Nënë Terezë, Hyrja I · 59A · Nr. 10
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
T/F: +383 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com
Website: www.ridea-ks.org

STUDIM

MBI

ÇËSHTJEN E SUKCESIONIT TË SHTETEVE NË DRITË TË 'FINALES SË MADHE' EVENTUALE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Shtator 2019

STUDIM

MBI

ÇËSH TJEN E SUKCESIONIT TË SH TETEVE NË

DRITË TË ‘FINALES SË MADHE’ EVENTUALE

NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Shtator 2019

Përmbajtja

Shkurtesat.....	i
Hyrje.....	1
Sfondi: Llojet e trashëgimisë së shtetit.....	1
Kosova si një shtet suksesor.....	3
Konventa e Vjenës mbi Sukcesionin e Shtetit dhe e Drejta Ndërkombëtare Zakonore...	7
Sukcesioni në lidhje me traktatet.....	9
'Shtetet e Reja të Pavarura' dhe Sukcesioni i Shteteve në Lidhje me Traktatet.....	15
Sukcesioni i Shteteve në Lidhje me Pronën dhe Borxhet.....	17
Përfundime dhe rekomandime.....	21

Shkurtesat

BPK	Bruto Produkti Kombëtar
BRSS	Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike
GDN	Grupi Drejtues Ndërkombëtar
GjND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
KS i OKB	Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
KVSS	Konventa e Vjenës për Sukcesionin e Shtetit
NP	Ndërmarrje Publike
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PCN	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
RSFJ	Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Hyrje

1. Pasi ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008, dhe pasi ka arritur njohjen nga 116 prej 193 shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara (deri më 18 shtator 2019), dhe pasi ka hyrë në organizata të shumta rajonale dhe ndërkombëtare, Republika e Kosovës tani është duke synuar të vendosë të drejtat dhe obligimet e veta si një shtet suksesor ndaj subjekteve të mëparshme ku ajo ishte pjesë përbërëse dhe nga e cila u administrua (do të thotë nga, Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK), pas shpërbërjes së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) në vitet 1991-92.
2. Ky punim do të përmbajë analizën e: së pari, të drejtës ndërkombëtare lidhur me suksesionin e shtetit; së dyti, Kosovës si një shtet suksesor; së treti, të drejtës ndërkombëtare për sa i përket suksesionit të shtetit në lidhje me traktatet; së katërti, Kosovës si një shtet i ri i pavarur; dhe së pesti, të drejtës ndërkombëtare rreth suksesionit të shtetit në lidhje me pronat dhe borxhet. Punimi përmbillet me një diskutim mbi opsionet politike dhe rekomandimet.

Sfondi: Llojet e trashëgimisë së shtetit

3. Sukcesioni i shtetit mund të paraqitet në numër të disa konteksteve, duke përfshirë dhënien ose lëshimin e territorit (për shembull, dhënia e Hong Kong-ut nga Mbretëria e Bashkuar në Republikën Popullore të Kinës në 1997), përfshirjen e një shteti në shtetin tjetër (për shembull, përfshirja e Republikës Demokratike Gjermane në Republikën Federale të Gjermanisë në vitin 1990), bashkimin e dy shteteve (për shembull, bashkimi i Veriut dhe Jugut të Yemen-it në vitin 1990), shpërbërjen e plotë të një shteti (siç është paraqitur me Republikën Socialiste Federale të Jugosllavisë në vitet 1991-92), dhe shkëputjen e një pjese të një shteti nga një shtet ekzistues, qoftë me konsensus (për shembull, shkëputja e Sudanit Jugor nga Sudani në vitin 2011) ose

pa konsensus (siç është shkëputja e Bangladeshit [Pakistani Lindor] nga Pakistani në vitin 1971).

4. Në rastet e shpërbërjes dhe shkëputjes, dy ose më shumë shtete dalin në territorin i cili më parë ishte vetëm një shtet. Të dy skenarët dallohen nëse mbetet një shtet i cili vazhdon me të njëjtin personalitet juridik, siç ishte më parë si shtet ekzistues, edhe pse me një numër të reduktuar të territorit dhe popullsisë. Në rast të shkëputjes, shteti i shkëputur është një *shtet suksesor*, një person i ri juridik ndërkombëtar i cili me anë të veprimit të së drejtës ndërkombëtare arrin të ketë të drejta dhe obligime të caktuara të shtetit në të cilin ishte pjesë e mëparshme; *shteti i mbetur* vazhdon përpara me personalitetin e njëjtë ligjor si shteti që ekzistonte më parë. Në rast të shpërbërjes, nuk ka shtet të mbetur; personaliteti juridik i shtetit i cili ka ekzistuar më parë është shuar dhe të gjitha shtetet e reja të cilat shfaqen në territorin e tyre kanë statusin e shtetit suksesor.
5. Dallimi në mes të shkëputjes dhe shpërbërjes varet në një vlerësim nëse shteti ekzistues ekziston përkundër reduktimit të territorit dhe popullsisë së saj (dhe potencialisht edhe një ndryshim të regjimit dhe emrit të tij politik). Njohja ndërkombëtare luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin nëse një rast i caktuar është rast i shkëputjes ose shpërbërjes. Kështu, republikat e tjera përbërëse të Bashkimit Sovjetik në dhjetor të vitit 1991, ranë dakord zyrtarisht për të shpërndarë Bashkimin Sovjetik dhe për të njohur Federatën Ruse si shtet të mbetur të ish-Bashkimit Sovjetik, kurse ish-republikat e tjera sovjetike si shtete suksesore. Duke reflektuar në këtë vendim, Federata Ruse vazhdoi automatikisht anëtarësimin e Bashkimit Sovjetik në Kombet e Bashkuara (duke përfshirë ulësen e përhershme në Këshillin e Sigurimit), ndërsa ish republikat e tjera sovjetike duhej të aplikonin për anëtarësim si shtete të reja.
6. Përkundrazi, Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ) nuk u njoh ndërkombëtarisht si një shtet i mbetur i Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (RSFJ) pas

shpërbërjes së kësaj të fundit. Komisioni i Arbitrazhit për ish-Jugosllavinë (Komisioni Badinter) theksoi më 29 nëntor të vitit 1991 se '[RSFJ] është në proces të shpërbërjes' dhe më 4 korrik të vitit 1992 theksoi se RSFJ 'nuk ekziston më'. Eventualisht, RFJ-ja vetë e braktisi pretendimin e saj ndaj vazhdimësisë, duke u pranuar në Kombet e Bashkuara si një shtet anëtar i ri në nëntor të vitit 2000 dhe duke hyrë në një *Marrëveshje për Çështjet e Sukcesionit në 2001*, të cilat i referoheshin RFJ-së si një nga pesë vendet suksore të RSFJ-së. Kështu, shpërbërja e RSFJ-së në mes të viteve 1990 dhe 1992 ishte një rast i shpërbërjes dhe jo i suksesionit.

7. RFJ-ja ishte ristrukturuar me kushtetutë si Union i shteteve të Serbisë dhe Malit të Zi në vitin 2003, megjithatë në vitin 2006 Mali i Zi shpalli pavarësinë, pas një referendum pavarësie. Më 5 qershor 2006, dy ditë pas shpalljes së pavarësisë, Kuvendi Serb miratoi një deklaratë 'Në obligimet e autoriteteve publike të Republikës së Serbisë duke supozuar fuqitë e Republikës së Serbisë si shtet suksesor të Unionit të Shteteve të Serbisë dhe Malit të Zi'. Pavarësisht nga përdorimi i termit 'shtet suksesor', është e qartë nga konteksti dhe praktika pasuese që Serbia pretendoi statusin e, dhe ishte e njohur ndërkombëtarisht si, shtet i mbetur i Unionit Shtetëror. Anëtarësimi i Serbisë në Kombet e Bashkuara vazhdoi, dhe Mali i Zi pohoi në të drejtat përkatëse. Kështu, ndarja e Serbisë dhe Malit të Zi është një shembull i shkëputjes e jo i shpërbërjes, ngjashëm me atë që ndodhi në Bashkimin Sovjetik në vitet 1991-92. Republika e Serbisë është një shtet i mbetur i (me personalitet të njëjtë juridik) RFJ-së/Unionit të Shteteve që u paraqit në vitin 1992 si një shtet suksesor i RSFJ-së. Mali i Zi është shtet suksesor i RFJ-së.

Kosova si një shtet suksesor

8. Republika e Kosovës shpalli pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008. E justifikuar për arsye ligjore, morale dhe politike, shpallja e pavarësisë ishte rezultati përfundimtar i një procesi ndërkombëtar të udhëhequr nga OKB për përcaktimin e statusit të Kosovës. Ky proces, i cili u mbajt gjatë periudhës 2005-2007, ishte i ndërmjetësuar

nga i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Procesin e Statusit të së Ardhmes për Kosovën, ish Presidenti Finlandez dhe laureati i Çmimit Nobel për Paqe, Martti Ahtisaari. Në fund të procesit negociues, Presidenti Ahtisaari propozoi që pavarësia e Kosovës të jetë e mbikëqyrur për një periudhë fillestare nga komuniteti ndërkombëtar në pritje të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin e Zgjidhjes së Kosovës (i njohur edhe si 'Plani i Ahtisarit'). Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së miratoi plotësisht propozimin e të Dërguarit të tij të Posaçëm, por nuk arriti të fitojë mbështetjen e Rusisë në Këshillin e Sigurimit. Përfaqësuesit e popullit të Kosovës të zgjedhur në mënyrë demokratike, kështu shpallën pavarësinë e shtetit, duke inauguruar një periudhë të 'pavarësisë së mbikëqyrur' të vëzhguar nga Grupi Drejtues Ndërkombëtar (GDN) dhe Përfaqësuesi i tij Civil Ndërkombëtar (PCN). Më 2 korrik 2012, GDN njoftoi se Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen ishte zbatuar me sukses. GDN në anën tjetër shpalli fundin e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës dhe përfundimit të mandatit të PCN-së më 11 shtator 2012.

9. Në një opinion konsultativ të 22 korrikut 2010, GJND-ja konfirmoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur ndonjë rregull të zbatueshëm të së drejtës ndërkombëtare; as nuk ka shkelur regjimin e veçantë të krijuar nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së apo Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë. Me fjalë të veta, 'Gjykata ka arritur në përfundim... se miratimi i shpalljes së pavarësisë së 17 shkurtit 2008 nuk ka shkelur të drejtën ndërkombëtare, rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit apo Kornizën Kushtetuese. Si pasojë, miratimi i atij deklarimi nuk ka shkelur ndonjë rregull të zbatueshëm të së drejtës ndërkombëtare.' Opinioni konsultativ konfirmoi pozicionin e Kosovës dhe atë të shteteve të shumta që kanë përhapur njohjen për Kosovën.

10. Kështu, Kosova në mënyrë të ligjshme u bë shtet i pavarur dhe sovran në vitin 2008. Duke zbatuar kornizën analitike të paraqitur në seksionin e mëparshëm, ndarja e Kosovës nga Serbia bie më shumë në kategorinë e shkëputjes sesa të shpërbërjes. Duke ndjekur shkëputjen ligjore të Kosovës, Serbia ka mbajtur shumicën e territorit

dhe popullsisë së saj, dhe ka vazhduar anëtarësimin e saj ekzistues në Kombet e Bashkuara, duke treguar se është e njohur ndërkombëtarisht si një shtet i mbetur i RFJ-së/Unionit të Shteteve/Serbisë. Për aq sa Kosova dhe shtetet që e njohin atë janë të interesuara, Kosova është kështu një shtet suksesor i RFJ-së/Unionit të Shteteve/Serbisë, siç është Mali i Zi (siç u diskutua në paragrafin 7).

11.A mund të argumentohet se Kosova nuk është një shtet suksesor i RFJ-së/Unionit Shtetëror/Serbisë por, më tepër, një shtet suksesor i RSFJ-së që u shpërbë në vitet 1990-92? Në nenin 9 të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, udhëheqësit e Kosovës të cilët u zgjodhën në mënyrë demokratike morën përsipër 'obligimet ndërkombëtare të Kosovës, duke përfshirë edhe ato të cilat ishin të përfshira në kuadër të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe traktatit dhe obligimeve të tjera të ish-Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, për të cilën ne jemi të lidhur si një ish-pjesë kushtetuese ... ' Kështu Deklarata e Pavarësisë njih se Kosova merr përsipër obligimet ndërkombëtare prej RSFJ-së dhe nga UNMIK-u, por nuk i referohet ndonjë suksesioni nga RFJ-ja/Unioni Shtetëror/Serbia.

12.Autoritetet Kosovare në fakt kanë tentuar të shpallin pavarësinë në vitin 1992, së bashku me Slloveninë, Kroacinë, Bosnjë Hercegovinën, dhe Maqedoninë, por ata ishin të paaftë të ushtrojnë kontroll territorial në atë kohë dhe nuk morën njohjen ndërkombëtare nga shtetet e tjera (përveç Shqipërisë). Mungesa e njohjes ndërkombëtare për Kosovën në atëkohë mund të gjendet në pjesë të vendimit të Komisionit të Badinterit që, në shpërbërjen e RSFJ-së, ish-kufijtë në mes republikave të RSFJ-së u bënë kufijë ndërkombëtar të mbrojtur nga e drejta ndërkombëtare në bazë të parimit *juridik uti possidetis*.

13.Megjithatë, më 2 korrik 1990, parlamenti i Kosovës ka deklaruar Kosovën republikë në Jugosllavi. Shpallja ishte reaksion i vendimit nga përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës —të zgjedhur me kujdes nga Serbia—më 23 mars 1989 për të hequr dorë nga

autonomia e mbrojtur kushtetuese e Kosovës. Pastaj, më 7 shtator 1990 në qytetin e Kaçanikut, i njëjti parlament shpalli Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kështu, mund të argumentohet se Kosova u bë një shtet me shpërbërjen e RSFJ-së bashkë me republikat e tjera kushtetuese të RSFJ-së, pavarësisht nga mosnjohja e Kosovës (përveç nga Shqipëria). Ky argument është në përputhje me opinionin e Komisionit Badinter dhe gjithashtu me logjikën se pavarësia e Kosovës nuk paraqet një precedent, që ka qenë shqetësim për shumë shtete, por në vend të kësaj paraqet një grup unik rrethanash.

14. Arsyetimi i Komisionit Badinter në fakt është kritikuar. Në mënyrë efektive iu dha republikave të RSFJ-së një të drejtë të supozuar të shtetësisë duke hequr Kosovën nga kjo e drejtë, vetëm në bazë të asaj se nuk ka pikërisht të njëjtin status nën ligjin kushtetues të RSFJ-së. Përveç vëzhgimit të mëparshëm (në paragrafin 13), ky arsyetim injoroi faktin se Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974 akordoi se edhe republikat edhe krahinat autonome të kenë një rol shumë të ngjashëm dhe shkallë të autonomisë. Kështu, Komisioni ndoshta do të duhej të zbatonte parimin *juridik uti possidetis* në Krahinën Autonome të Kosovës në të njëjtin pozicion me republikat e RSFJ-së, duke ia dhënë një të drejtë supozuese për t'u bërë shtet duke ndjekur shpërbërjen e RSFJ-së.

15. Edhe pse këto pika janë imponuese, ka ende vështirësi në argumentimin se Kosova kurrë nuk u bë pjesë e RFJ-së. Edhe nëse parimi *uti possidetis* do të ishte zbatuar në mënyrë të drejtë, përsëri do të kishte krijuar një supozim se Kosova duhet të marrë shtetësinë pas shpërbërjes së RSF-së, duket qartë se Kosova në fakt nuk u bë shtet deri në vitin 2008. RFJ kryesisht mbajti kontrollin efektiv territorial deri në Luftën e Kosovës 1998-99, pas së cilës u themelua UNMIK-u. Përveç kësaj, deri në vitin 2008 Kosova konsiderohej ndërkombëtarisht si pjesë e territorit të RFJ-së, siç pohohet, për shembull, në Rezolutën 1244 (1999) të KS të OKB-së. Për më tepër, Shpallja e Pavarësisë e vitit 2008 themelon shtetësinë e pavarur të Kosovës që nga dita e shpalljes.

16. Si pasojë, nuk duket që Kosova mund të jetë një shtet suksesor i drejtpërdrejt i RSFJ-së. Përkundrazi, është një shtet suksesor i RFJ-së/Unionit Shtetëror/Serbisë. Raporti i Ahtisaarit (në Aneksin VI) thekson se 'Kosova do të marrë pjesën e saj të borxhit ndërkombëtar të Republikës së Serbisë', një dispozitë që supozon se Kosova ishte më parë pjesë e RFJ-së/Unionit Shtetëror/Serbisë. Shpallja e Pavarësisë së Kosovës në anën tjetër thekson se '[n]e i pranojmë plotësisht detyrimet për Kosovën të përfshira në Planin e Ahtisaarit.'

17. Kështu, Kosova duket të jetë një shtet suksesor i RFJ-së/Unionit Shtetëror/Serbisë. Megjithatë, statusi i Kosovës në mes viteve 1999 dhe 2008 shkakton ndërlikime. Gjatë kësaj kohe, edhe pse në një interpretim strikt të ligjeve Kosova konsiderohej ndërkombëtarisht si pjesë e RFJ-së/Unionit Shtetëror/Serbisë, administrimi i saj u krye nga UNMIK nën mandatin e Këshillit të Sigurimit, në përputhje me Kapitullin VII të Kartës së OKB-së. Fuqitë juridike të UNMIK-ut kanë përfshirë krijimin e marrëveshjeve dypalëshe me shtetet e treta në kuadër të Kosovës në çështjet që janë brenda përgjegjësisë së saj. Në një shënim verbal më 12 mars 2004, Ndihmëssekretari i Përgjithshëm i OKB-së për Çështjet Ligjore këshilloi se konventat ndërkombëtare të hyra nga RFJ-ja/Unioni Shtetëror pas 10 qershorit 1999 (themelimi i UNMIK-ut) 'automatikisht nuk janë të zbatueshme në Kosovë, edhe pse mund të bëhen të zbatueshme në të nga përfshirja përmes një marrëveshjeje dypalëshe në mes të UNMIK dhe shtetit të tretë.' Kështu, Kosova nuk mund të lidhet nga detyrimet e hyra nga RFJ-ja/Unioni Shtetëror/Serbia në mes të 10 qershorit 1999 dhe 17 shkurtit 2008, vetëm nga ato të hyra nga UNMIK.

Konventat e Vjenës mbi Sukcesionin e Shtetit dhe e Drejta Ndërkombëtare Zakonore

18. Sukcesioni i shtetit është një fushë komplekse dhe kontradiktore e së drejtës ndërkombëtare. Në vitet 1970 dhe në fillim të viteve 1980, Komisioni i së Drejtës

Ndërkombëtare ka punuar në dy traktate të cilat u munduan të qartësojnë (dhe zhvillojnë) të drejtën ndërkombëtare në këtë fushë: Konventa e Vjenës në Sukcesionin e shtetit në lidhje me Traktatet 1978 (KVSS 1978) dhe Konventa e Vjenës në Sukcesionin e shtetit në lidhje me Pronën, Arkivat dhe Borxhet e shtetit (KVSS 1983). Megjithatë, asnjëra Konventë nuk është ratifikuar gjerësisht. KVSS 1978 është në fuqi, mirëpo ka vetëm 22 palë. KVSS 1983 ka vetëm 7 palë dhe ende nuk ka hyrë në fuqi. Sukcesioni i shtetit është kështu, një çështje e qeverisur gjerësisht nga e drejta ndërkombëtare zakonore, përfshirë dhe rastin e Kosovës (edhe pse Serbia është palë në KVSS 1978, Kosova nuk është). Por, ekziston një mosmarrëveshje e konsiderueshme për përmbajtjen e të drejtës zakonore përkatëse, si shkak i mospërputhjeve në interpretime të ndryshme të praktikës shtetërore.

- 19.** Rregulli i përgjithshëm i KVSS 1978 është që, shtetet suksesore automatikisht lidhen me traktatet në fuqi të shtetit paraardhës, përveç nëse kjo nuk do të ishte në pajtueshmëri me objektin dhe qëllimin e traktatit ose do të ndryshonte rrënjësisht kushtet për funksionimin e tij. Praktika që dalin me ndarjen e Bashkimit Sovjetik, Çekosllovakisë dhe RSFJ-së duket se më së shumti e mbështesin një supozim të suksesionit në relacion me traktatet shumëpalëshe. Ndërsa, nëse suksesioni automatik vlen edhe për traktatet dypalëshe është ende e diskutueshme. Në praktikë, shkëmbimi dypalësh i shënimeve zakonisht ndodh për të konfirmuar zbatueshmërinë e vazhdueshme të traktateve ekzistuese, por është e hapur për interpretim nëse një shkëmbim i tillë shënimesh njeh një suksesion automatik i cili tashmë ka ndodhur ose nëse ai ka një efekt konstitutiv. Sa i përket KVSS 1983, parimi i përgjithshëm në suksesionin për pronat dhe borxhet (që kërkojnë ndarje të barabartë) janë ngjashëm të pasqyruara të drejtën zakonore, por nuk përmbajnë shumë udhëzime konkrete. *Instituti de Droit International (Instituti i së drejtës ndërkombëtare)*, një grup avokatësh ndërkombëtarë, ka sugjeruar një numër rregullash më specifike që synojnë plotësimin e boshllëkut, megjithëse nuk është e qartë se në çfarë mase këto rregulla pasqyrojnë praktikën ekzistuese shtetërore.
- 20.** Së paku disa prej dispozitave të KVSS 1978 dhe të KVSS 1983 janë të pasqyruara në të drejtën zakonore ndërkombëtare, edhe pse deri në një lloj mase është një çështje

mosmarrëveshjeje. Komisioni Badinter theksoi (në Opinionin Nr. 9) se 'sukcesioni i shteteve udhëhiqet nga parimet e së drejtës ndërkombëtare i bashkëngjitur në Konventat e Vjenës [të vitit 1978 dhe 1983]'. Në Opinionin Nr. 13, Komisioni mori një pikëpamje ekuivalente ndërkohë që 'ka disa parime të themeluara mirë të së drejtës ndërkombëtare që zbatohen për suksesion shtetëror... Konventat e viteve 1978 dhe 1983 ofrojnë disa drejtime.' Në kontekstin e shpërbërjes së RSFJ-së, të gjitha ish-republikat u pajtuan që parimet e pasqyruara në KVSS 1978 dhe 1983 ishin të zbatueshme.

Sukcesioni në lidhje me traktatet

21. Dispozita e përgjithshme në KVSS 1978 që rregullon suksesionin e shtetit në lidhje me traktatet në rastet kur një pjesë apo disa pjesë të territorit të shtetit ndahen për të formuar një shtet të ri ose shtete të reja gjendet në Nenin 34. Ky Nen përmban një rregull të përgjithshëm se shtetet suksesore automatikisht lidhen me traktatet në fuqi për shtetin paraardhës në datën e suksesionit (vetëm nëse marrëveshje të tilla janë të kufizuara territorialisht në territor që nuk bëhet territor i shtetit suksesor). Ky rregull i përgjithshëm i suksesionit automatik zbatohet pavarësisht nëse shteti paraardhës vazhdon të ekzistojë ose jo, do të thotë në të dy rastet të shpërbërjes dhe të shpërbërjes. Megjithatë, suksesioni automatik nuk zbatohet nëse a) shtetet e interesuara bien dakord ndryshe; ose b) thuhet në traktat ose është vendosur ndryshe që zbatimi i traktatit në lidhje me shtetin suksesor do të ishte i papajtueshëm me objektin dhe qëllimin e traktatit ose do të ndryshonte rrënjësisht kushtet për funksionimin e tij.

22. Neni 34 është një dispozitë e përgjithshme. Dispozitat e tjera më specifike në Konventë, zbatohen në lloje të veçanta të traktateve. Në këtë mënyrë, Neni 11 dhe 12 i Konventës vërtetohet se shteti suksesor nuk ndikon në regjimet kufitare ose detyrimet që lidhen me përdorimin e territorit të caktuar. Duke pasqyruar nevojën për stabilitet në çështje territoriale, suksesioni automatik zbatohet tek të gjitha traktatet e këtij

lloji. Këto rregulla janë gjithashtu pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare, siç vërtetohet nga GjND-ja në rastin e *Gabčíkovo–Nagyymaros Project*. Në anën tjetër, Neni 4 shpreh se KVSS 1978 është pa paragjykim për rregullat në lidhje me marrjen e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare. Në shumicën e rasteve, shtetet suksore (në kundërshtim me shtetet e mbetura) nuk arrijnë tek anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe duhet të aplikojnë që të bëhen anëtarë të rinj, siç ka bërë Kosova vazhdimisht.

23. Pozicioni në anën e suksesionit automatik i miratuar në Nenin 34 mbetet i diskutueshëm. Pasqyron një dëshirë për të siguruar stabilitet legal kur paraqitet suksesioni i shteteve. Pozicioni plotësisht i kundërt—që njihet edhe si qasja ‘propozim i pastër’—pretendon se pasi shteti i ri nuk është pajtuar me traktatet përkatëse, nuk duhet të kufizohet automatikisht nga to pa një shprehje të re të pëlqimit. Në kontrast me rregullin e përgjithshëm të Nenit 34 që përkrah suksesionin automatik, një variacion i qasjes së propozimit të pastër ishte zbatuar në KVSS 1978 në ‘shtetin më të ri të pavarur’ (ish varësi koloniale që morën pavarësinë), por pasi që procesi i dekolonizimit ka përfunduar në masë të madhe, pak shtete të reja do të bien në atë kategori (megjithatë shih diskutimin e mëtejshëm më poshtë në paragrafët [32] deri në [37]).

24. Pasi që KVSS 1978 nuk ka qenë e ratifikuar gjerësisht, pyetja kryesore është nëse rregulli i përgjithshëm i suksesionit automatik në Nenin 34 është pasqyruar në të drejtën ndërkombëtare zakonore. Praktika shtetërore është e hapur për interpretime të ndryshme në këtë pikë. Shoqata Ndërkombëtare e Drejtësisë në vitin 2008 gjeti se Neni 34 u referua nga shumica e shteteve suksore në rastet e shpërbërjes dhe shkëputjes dhe se këto shtete e konsideronin veten si suksesor të traktateve shumëpalëshe të hyra nga shtetet paraardhëse. Sidoqoftë, në raste të tjera shtetet miratuan qasjen e propozimit të pastër duke e bërë pasardhësin opsional. Praktika e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së ka qenë që të kërkojë që shtetet suksore të prodhojnë deklarata të veçanta të trashëgimisë në lidhje me traktatet shumëpalëshe,

në të cilat OKB-ja është depozituesi, duke ngritur kështu pyetjen nëse suksesioni ndodh automatikisht në mungesë të një deklarate të tillë. Në disa raste, shtetet suksesore kanë hyrë në traktate shumëpalëshe, në të cilat shteti paraardhës ishte palë, si një palë e re në vend që të bënte një deklaratë të suksesionit. Rasti ligjor i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë gjithashtu nuk është plotësisht i qartë. Në Aktgjykimin e tij të vitit 1996 mbi Kundërshtimet Paraprake në rastin e *gjenocidit në Bosnje*, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme të shprehet nëse zbatohet një rregull i suksesionit automatik për traktatet. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata shmangi një prononcim të përgjithshëm për trashëgiminë automatike në traktate dypalëshe në gjykimin e vitit 1997 në çështjen *Projekti Gabčíkovo-Nagymaros*, duke kufizuar arsyetimin e saj për traktate me karakter territorial (shih paragrafin 22).

25. Megjithatë, përkundër natyrës komplekse të praktikës shtetërore, tendenca mbizotëruese që nga vitet 1990 ka qenë mbështetëse e një supozimi se traktatet vazhdojnë të zbatohen për shtetet suksesore. Ky pozicion është miratuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan në 1992 dhe gjithashtu nga shtetet anëtare të BE-së në përgjigje të ndarjes së RSFJ-së dhe Çekosllovakisë, me disa shtete siç është Austria, e cila më parë është konsideruar si një qasje e 'propozimit të pastër,' duke u zhvendosur në një pohim të vazhdimësisë. (Disa kanë argumentuar se supozimi zbatohet vetëm në rastet e shpërbërjes dhe jo në rastet e shkëputjes, por nuk është e dukshme që shtetet mbështeten në këtë ndryshim në praktikë). Në këtë pikëpamje, praktika e përbashkët e njoftimit të suksesionit për depozitimin e traktateve shumëpalëshe, si në rastin e traktateve të OKB-së, nuk është një kërkesë për suksesion.

26. Megjithëse GjND-ja ka refuzuar të njoftojë nëse ka një rregull të përgjithshëm të suksesionit automatik, arsyetimi i saj duket se mbështet një supozim të suksesionit. Në rastin e *Konventës së Gjenocidit (Kroacia kundër Serbisë)*, Kroacia pohoi se RFJ-ja ishte një palë nga suksesioni në Konventën e Gjenocidit që nga fillimi i ekzistencës së saj si shtet. Gjykata iu referua një deklaratë nga Asambleja Kushtetuese e RSFJ-së në

vitin 1992 se 'do të respektonte rreptësisht të gjitha angazhimet që RFSJ-ja mori përsipër ndërkombëtarisht', një deklaratë e transmetuar në një shënim tek Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së (edhe pse jo si një njoftim zyrtar për të si depozitar traktatesh). Përkundër faktit se në atë kohë RFJ po pretendonte të ishte shteti vazhdues i RSFJ-së, Gjykata vendosi që deklaratat e vitit 1992 duhet të konsiderohet se ka pasur efektet e njoftimit të suksesionit të traktateve. Gjykata, gjithashtu, vlerësoi se ndryshe nga ratifikimi ose hyrja në një traktat si palë e re, njoftimi i suksesionit 'lidhet me një grup rrethanash tashmë ekzistuese dhe përbën një njohje nga ai Shtet për pasoja të caktuara juridike që rrjedhin nga ato rrethana, në mënyrë që çdo dokument i lëshuar nga Shteti në fjalë, duke qenë thelbësisht konfirmues, mund t'i nënshtrohet kërkesave më pak të ngurta të llojit.' Kështu, pranimi i përgjithshëm nga RFJ-ja për suksesionin e saj në detyrime ndërkombëtare të RSFJ-së u mjaftua për të vërtetuar që ishte palë në Konventën e Gjenocidit në kohën përkatëse.

27. Arsyetimi i GjND-së nuk zgjedh nëse njohja nga ana e shtetit suksesor e trashëgimisë së tij ndaj detyrimeve të traktatit është konstitutive ose thjesht deklarative, kështu që shteti automatikisht do të kufizohej me detyrimet e traktatit pa ndonjë shprehje miratimi ana e tij (megjithëse citimi në paragrafin e mëparshëm mund të lexohet për të mbështetur pikëpamjen deklarative, dhe Gjyqtari Elaraby veçanërisht miratoi një rregull të suksesionit automatik edhe pse në mungesë të deklaratës në opinionin e ndarë të tij në *Ligjshmëria e përdorimit të forcës - Serbia dhe Mali i Zi kundër Belgjikës*). Gjykimi i GjND-së në *Kroacia kundër Serbisë* tregon, megjithatë, se një deklaratë e gjerë dhe e përgjithshme nga shteti suksesor duke pranuar detyrimet ndërkombëtare të shtetit paraardhës mund të jetë e mjaftueshme për të themeluar kërkesën e vazhdueshme të traktateve ekzistuese. Kështu, Deklarata e Pavarësisë së Kosovës që ndërmerr 'detyrimet ndërkombëtare të Kosovës, duke përfshirë ato të lidhura në emër tonë nga UNMIK-u dhe traktate e detyrime të tjera nga ish-Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë për të cilën ne jemi të lidhur si një ish-pjesë konstitutive ... ' përcakton se Kosova ka hyrë në traktate të lidhura nga RSFJ-ja dhe UNMIK-u, megjithëse e lë të paqartë statusin e traktateve të lidhura nga RFJ-ja para 10 qershorit 1999 (shih paragrafin 16). Megjithëse, për shkaqe politike Kosova nuk ka qenë në

gjendje të paraqesë njoftim zyrtar të suksesionit në lidhje me konventat shumëpalëshe të OKB-së tek Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, arsyetimi i GjND-së sugjeron që pranimi i Kosovës ndaj detyrimeve ndërkombëtare në Deklaratën e Pavarësisë është i mjaftueshëm që ajo të bëhet palë nga suksesioni i traktateve shumëpalëshe, tek të cilat RSFJ-ja ishte palë.

28. Edhe nëse ekziston një supozim i përgjithshëm në favor të suksesionit në lidhje me traktatet, kjo nuk vlen për të gjitha traktatet. Një përjashtim i diskutuar në paragrafin 22 përfshin anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. Në përgjithësi, siç tregon Neni 34, suksesion automatik nuk mund të ndodhë kur kjo është në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e traktatit ose ndryshon rrënjësisht kushtet për funksionimin e tij. Një shembull i pranuar gjerësisht i një traktati të tillë është një aleancë politike ose ushtarake dhe si një traktat i tillë është i lidhur ngushtë me identitetin e palëve kontraktuese. Ngjashëm, në disa raste është përfunduar se traktatet e çarmatimit nuk zbatohen tek shtetet suksesore (në krahasim me shtetet e mbetura) si në rastin e traktateve dypalëshe të çarmatimit të SHBA-Bashkimi Sovjetik. Në të kundërt, është argumentuar se është një rregull i veçantë për suksesionin automatik në traktatet për të drejtat e njeriut; megjithëse GjND-ja nuk u bazua në këtë argument në *Gjenocidin Boshnjak* dhe rastet e *Kroacisë kundër Serbisë*, Gjyqtari Weeramantry, në Opinionin e tij të Ndarë në rastin e *Kroacisë kundër Serbisë*, u bazua në këtë argument.

29. Përgjithësisht, derisa një prezumim i vazhdueshmërisë ka mundësi të zbatohet në traktate shumëpalëshe të hapura në përgjithësi për shtetet, është më pak e qartë nëse ai aplikohet për traktate dypalëshe ose traktate të tjera që synojnë të kufizohen në një numër të kufizuar palësh. Neni 34 i KVSS 1978 nuk bën dallime në mes traktateve shumëpalëshe dhe dypalëshe, me sa duket duke zbatuar parimin e suksesionit automatik tek të dyja. Por disa studiues argumentojnë se traktatet dypalëshe përcaktohen nga numri i kufizuar i palëve dhe për t'i zbatuar ato në një shtet të ri rrënjësisht ndryshon funksionimin e traktatit sipas përkufizimit. Kështu, në këtë këndvështrim, traktatet dypalëshe zbatohen vetëm tek shtetet e reja nëse të dy palët

pajtohen se ato duhet të vazhdojnë në fuqi (ose nëse ato bien në kategorinë e traktateve territoriale të diskutuara në paragrafin 22).

30. Asociacioni i së Drejtës Ndërkombëtare në vitin 2008 doli në përfundimin se e ardhmja e traktateve dypalëshe të lidhura nga shteti paraardhës vendoset përgjithësisht përmes negociatave midis shtetit suksesor dhe palës tjetër. Kosova ka lidhur marrëveshje për sukcesionin e traktateve me një numër shtetesh, duke përfshirë Austrinë, Belgjikën, Republikën Çeke, Finlandën, Francën, Gjermaninë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Marrëveshje të tilla sqarojnë se traktatet dypalëshe të zbatueshme më parë vazhdojnë të zbatohen. Për shembull, Mbretëria e Bashkuar vitin 2008 në një shkëmbim letrash me Kosovën konfirmoi që 'traktatet dhe marrëveshjet në fuqi për të cilat Mbretëria e Bashkuar dhe UNMIK-u, Mbretëria e Bashkuar dhe RSFJ-ja, apo Mbretëria e Bashkuar dhe Republika Federale e Jugosllavisë ishin palë, mbeten në fuqi në mes të Mbretërisë së Bashkuar dhe Republikës së Kosovës'. (Për diskutimin e shkallës në të cilën Kosova ka trashëguar traktatet e RFJ-së, shih diskutimin në paragrafët [11]-[17], më lartë).

31. Në mungesë të një marrëveshje të tillë, statusi i traktateve dypalëshe është më pak i qartë. Sidoqoftë, ka vendime të arbitrazhit të cilat duket se mbështesin mendimin se traktatet e investimeve dypalëshe automatikisht obligojnë një shtet suksesor. Veçanërisht, në rastin e vitit 2015 të *Mineraleve në Botë kundër Kazakistanit*, ishte konsideruar se Kazakistani ishte i lidhur si një shtet suksesor i Bashkimit Sovjetik nga Kanada-BRSS TBI i vitit 1989, megjithëse teksti i vendimit ishte konfidencial dhe arsyetimi i saktë i Gjykatës nuk është i ditur. Kjo do të ishte në linjë me parimin e sukcesionit automatik siç u parashtrua në Nenin 34 KVSS 1978. (Në kontekstin e Kosovës, një gjykatë e arbitrazhit supozoi se Kosova ishte palë e Gjermanisë-RSFJ-së TBI e vitit 1990, por kjo mund t'i atribuohet faktit se Kosova dhe Gjermania kanë lidhur një marrëveshje për traktatin e sukcesionit dhe se asnjëra palë në këtë rast nuk e kundërshtoi zbatimin e traktatit: *ACP Axos Capital kundër Kosovës*).

'Shtetet e Reja të Pavarura' dhe Sukcesioni i Shteteve në Lidhje me Traktatet

32. KVSS 1978 përmban një grup rregullash të ndara të cilat janë të zbatueshme në rastin e 'Shteteve të reja të pavarura'. Një shtet i ri i pavarur është i definuar në Nenin 2(f) si 'një Shtet suksesor, territori i të cilit menjëherë para datës së suksesionit të shteteve ishte një territor i pavarur për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit Shteti paraardhës ishte përgjegjës'. Territoret e mëparshme koloniale do të cilësoheshin si një territor i varur në këtë kontekst. Në kundërshtim me rregullin e përgjithshëm të suksesionit automatik në Nenin 34, KVSS 1978 zbaton rregullin e propozimit të pastër në shtetet e reja të pavarura. Një shtet i tillë, në përgjithësi, nuk është i lidhur nga traktatet për shkak të suksesionit, por mund të vendoset si një palë në një traktat shumëpalësh të zbatueshëm më parë duke njoftuar depozituesin (ose nëse nuk ka depozitarë, palët), përveç nëse kjo nuk do të ishte në pajtueshmëri me objektin dhe qëllimin e traktatit ose rrënjësisht do të ndryshojë kushtet për veprimin e tij. Traktatet dypalëshe vazhdojnë të jenë në fuqi vetëm kur të dy shtetet e pavarura rishtazi dhe pala tjetër shtetërore janë dakord në mënyrë eksplicite, ose për shkak të sjelljes së tyre (implicite) konsiderohen se janë pajtuar.

33. Dispozitat në lidhje me shtetet e reja të pavarura, siç u përmend, kishin për qëllim të aplikoheshin për ish-kolonitë. Zbatueshmëria e rregullit 'propozim i pastër' pasqyroi pikëpamjen se statusi kolonial shkelte të drejtën e vetëvendosjes, dhe se kjo e drejtë kërkonte që shteti i ri të mos kufizohej nga traktatet e lidhura (dhe kështu 'e imponuara') nga fuqia koloniale përveç nëse zgjedh të pohojë traktate të tilla. (Duhet të theksohet megjithatë se rregullat e veçanta për traktatet territoriale dhe organizatat ndërkombëtare, diskutuar në paragrafin 22, gjithashtu zbatohen në shtetet e reja të pavarura).

34. Në disa raste të dekolonizimit që kanë ndodhur që nga viti 1978, shtetet e reja të pavarura në përgjithësi kanë pretenduar të drejtën të zgjedhin nëse duhet të pranojnë

apo jo traktate të zbatueshme më parë, në përputhje me dispozitat e KVSS 1978. Kështu, mund të argumentohet se këto rregulla pasqyrojnë të drejtën zakonore ndërkombëtare. Sidoqoftë, supozohet gjerësisht se me fundin e dekolonizimit koncepti ka humbur rëndësinë e tij praktike. Në përgjithësi, shtetet e reja që dalin jashtë kontekstit kolonial që nga fundi i Luftës së Ftohtë nuk janë konsideruar të jenë në kategorinë e shteteve të pavarura rishtazi.

35. Mund të argumentohet se koncepti i një shteti të pavarur rishtas duhet të zgjerohet për t'u aplikuar jashtë kontekstit kolonial, në raste të tjera ku shkëputja ndodh si pasojë e ushtrimit të së drejtës për vetëvendosje. Në veçanti, koncepti mund të zbatohet në rastet e shkëputjes riparuese/korrigjuese, kur një grup i pakicave brenda një shteti ekzistues shkëputet si përgjigje ndaj diskriminimit serioz ose abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut. Ashtu si në rastin e ish-kolonive, duket se është e padrejtë që një shtet i ri të jetë i detyruar ndaj obligimeve të lidhura nga një shtet paraardhës që ka shkelur të drejtën e popullit të tij për vetëvendosje. Ndarja e Kosovës nga Serbia ndonjëherë konsiderohet të jetë një shembull i shkëputjes korrigjuese/riparuese në ushtrimin e vetëvendosjes.

36. Për të mbështetur këtë argument, mund t'i referohemi teksteve përgatitore të KVSS 1978. Ato sugjerojnë se arsyetimi që ndodhet nën rregullin e veçantë në 'shtetet e reja të pavarura' ishte se popullata e territoreve të varura kishte qenë e paaftë për të marrë pjesë në qeveri dhe politikë të jashtme të shtetit paraardhës dhe prandaj nuk duhet të jetë e lidhur nga traktatet në të cilët ata nuk kishin zë. Megjithatë, autorët e traktatit fillimisht kishin në mendje kolonitë e ndara gjeografikisht nga territori kryesor i shtetit paraardhës, mirëpo duket arbitrare përkufizimi i kategorisë në këto situata. Mund të argumentohet bindshëm se çdo territor, populli i të cilit sistematikisht u diskriminua dhe u përjashtua nën shtetin paraardhës, duhet të jetë në të njëjtën kategori. Ky argument mbështetet nga Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të vitit 1970 mbi Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare në lidhje me Marrëdhëniet Miqësore dhe Bashkëpunimit midis Shteteve, e cila tregon se

e drejta e vetëvendosjes shkelet kur një shtet nuk posedon 'një qeveri që përfaqëson tërë popullin që i përket një territori, pa asnjë dallim race, feje apo ngjyre'. Qeveria e RFJ-së ka shkelur të drejtën e vetëvendosjen në këtë mënyrë: sistematikisht diskriminoi popullin e Kosovës dhe i përjashtoi ata masivisht nga përfaqësimi dhe pjesëmarrja politike, duke e përfshirë këtu punët e jashtme dhe procesin e lidhjes së traktateve. Kosova kështu ishte një 'territor i varur' pa lirinë për të marrë pjesë në kryerjen e marrëdhënieve ndërkombëtare, me fjalë të tjera, ishte në pozicionin e njëjtë si një koloni. Gjithashtu, duke krijuar të drejtën e shkëputjes riparuese/korrigjuese, sugjerohet që Kosova duhet të konsiderohet një shtet i pavarur rishtazi, njëlloj si një koloni e dikurshme.

37. Megjithatë, ka vështirësi të përfshira në këtë argument. Së pari, doktrina e shkëputjes korrigjuese është në vetvete kontradiktore dhe zbatueshmëria në kontekstin e suksesionit të shtetit do të ishte e re. Së dyti, nuk është e qartë nëse pretendimi i statusit të shtetit të ri të pavarur do të ishte i dobishëm për Kosovën. Dispozitat kërkojnë që shtetet e reja të pavarura 'të zgjedhin' në traktatet shumëpalëshe që kanë qenë të zbatueshme më herët nga njoftimi i depozitave, por në rastin e Kosovës mund të jenë pengesat politike që shteti i mbetur të pranojnë njoftimin. Dispozitat në lidhje me traktatet dypalëshe, të cilat kërkojnë miratimin e palës tjetër si dhe shtetit të ri, ashtu që këto lloj traktatesh të vazhdojë në fuqi, mund të jetë më pak i favorshëm për shtetet suksore, sesa suksesioni automatik për traktatet dypalëshe, që supozohet të jetë (edhe pse jo me siguri) rregull i përgjithshëm (shih paragrafët [29]–[31] më lart).

Sukcesioni i Shteteve në Lidhje me Pronën dhe Borxhet

38. KVSS e vitit 1983 përmban rregulla të zbatueshme në suksesionin e shteteve në lidhje me pronat, borxhet dhe arkivat shtetërore. Megjithatë, siç është vënë në pah nga Asociacioni i së Drejtës Ndërkombëtare në 2008, këto rregulla janë kryesisht të përgjithshme në natyrë dhe ndihmëse të marrëveshjeve të arritura në mes të shteteve

të interesuara. Për më tepër, siç u përmend më herët, KVSS e vitit 1983 ka shumë pak palë dhe asnjëherë nuk ka hyrë në fuqi (pjesërisht për shkak të pakënaqësisë në lidhje me parimin e sovranitetit të përhershëm të shteteve të reja të pavarura mbi burimet natyrore). Këto aspekte të suksesionit janë të rregulluara nga e drejta zakonore, por parimet zakonore të zbatueshme janë mjaft të paqarta.

39.Në Opinionin e tij Nr. 12, Komisioni i Badinter-it deklaroi se rregulli themelor i zbatuar në suksesionin e pronave, arkivave dhe borxheve shtetërore është se shtetet duhet të arrijnë një rezultat të drejtë me negociata dhe marrëveshje. U theksua se nëse njëra nga palët në fjalë nuk pranoi të bashkëpunonte, do të shkelte atë detyrim themelor dhe do të ishte përgjegjëse ndërkombëtarisht, gjë që potencialisht do të lejonte që shtetet që mbajnë humbje të marrin masa jo të detyrueshme në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Pas një periudhe të jo-bashkëpunimit nga RFJ-ja, një marrëveshje ishte arritur në vitin 2001 nga pesë shtetet suksesore të RSFJ-së në lidhje me suksesionin e pronave, borxheve dhe arkivave të RSFJ-së.

40.Nëse marrëveshja nuk mund të arrihet, është e qartë se në rast të shkëputjes pronat e paluajtshme të shtetit paraardhës në territorin e shtetit suksesor, kalojnë tek shteti suksesor (Neni 17(1)(a) KVSS 1983), siç është e miratuar nga praktika e shtetit. Pozicioni në lidhje me pronat e luajtshme është më pak i qartë. Neni 17 (1)(b) thekson se pronat e luajtshme të shtetit të lidhura me aktivitetin e shtetit paraardhës në lidhje me territorin e shtetit suksesor kalojnë tek shteti suksesor. Në të kundërtën, Komisioni i Badinter-it thekson më thjeshtë (në Opinionin Nr. 14) që 'pronat publike kalojnë tek shteti suksesor në territorin e të cilit ndodhen' dhe që 'origjina ose financimi fillestar i pronës dhe çdo hua ose kontribut i bërë në lidhje me të nuk kanë asnjë ndikim në këtë çështje'.

41.Sa i përket pronave të paluajtshme të vendosura në shtetin e tretë (për shembull, ambasadat), Neni 18 i KVSS së vitit 1983 parasheh se në rast të shpërbërjes së shtetit paraardhës duhet të kalojë tek shteti suksesor në proporcione të barabarta. Megjithatë, nuk thuhet e çfarë rregulli zbatohet në rastin e shkëputjes nga një shtet

para-ekzistues i cili vazhdon të ekzistojë (siç është rasti i Kosovës). Duke pasur parasysh parimin thelemor të barazisë që rregullon sukcesionin e shtetit në këtë fushë, pikëpamja e Institut de Droit International (IDI) në Nenin 19 të Rezolutës 2001 në Sukcesionin e Shteteve në Çështjet e Pronave dhe Borxheve identifikon saktë të drejtën ndërkombëtare zakonore: në rastet e shkëputjes, shteti suksesor ka të drejtë të ndajë në mënyrë të barabartë pronën e shtetit paraardhës të vendosur jashtë territorit të tij. Shteti suksesor ka gjithashtu të drejtën në proporcion të barabartë të pasurive të tjera të luajtshme të shtetit paraardhës (Neni 17(1)(c) KVSS 1983) dhe për të gjitha pronat e tjera, të drejtat dhe interesat e shtetit paraardhës (Neni 20, Rezoluta IDI e vitit 2001). Parimet themelore gjithashtu sugjerojnë se pronat e rëndësishme të trashëgimisë kulturore të shtetit suksesor duhet të kalojnë tek ai shtet (Neni 16(5) Rezoluta IDI e vitit 2001).

42. Borxhi shtetëror, siç përcaktohet në KVSS e vitit 1983, nënkupton çdo detyrim financiar të një shteti paraardhës që lind në përputhje me të drejtën ndërkombëtare ndaj një shteti tjetër, një organizate ndërkombëtare ose ndonjë subjekti tjetër të së drejtës ndërkombëtare. Rezoluta e IDI e vitit 2001 zgjeron përkufizimin që përfshin detyrime financiare ndaj çdo personi fizik ose juridik sipas ligjit të brendshëm. Në mungesë të marrëveshjes në mes të shtetit paraardhës dhe suksesor, borxhi shtetëror duhet të kalojë tek shteti suksesor në proporcion të barabartë, duke marrë parasysh pronën, të drejtat dhe interesat të cilat kalojnë tek shteti suksesor në lidhje me atë borxh shtetëror (Neni 40 KVSS; neni 23 i Rezolutës IDI të vitit 2001). Disa praktika të fundit të shteteve sugjerojnë se borxhet e lokalizuara (borxhet e krijuara nga shteti paraardhës, por për përfitime të pjesës së shkëputur) janë të trashëguara nga shteti suksesor, megjithëse Neni 28 i Rezolutës së IDI 2001 parashikon që të gjitha përfitimet për shtetin suksesor të merren parasysh në shpërndarjen e përgjithshme të barabartë.

43. Prapë, këto parime të përgjithshme mund të vihen mënjanë me marrëveshje midis shteteve në fjalë. Kështu, Federata Ruse pranoi në tërësi borxhin Sovjetik, një vendim mesa duket i lidhur me dëshirën e saj për të marrë përkrahje ndërkombëtare për

kërkesën e saj (të suksesshme) për të qenë shtet i pasues/mbetur i Bashkimit Sovjetik.

44. Ndër faktorët relevant për vendosjen e një shpërndarje të barabartë, bazuar në IDI, janë pjesët përkatëse në Bruto Produktin Kombëtar (BPK) të shteteve të interesuara në kohën e sukcesionit ose në kohën e vendimit ose marrëveshjes për ndarjen, dhe formula e miratuar nga FMN për ndarjen e kuotave midis shteteve në fjalë (Neni 11, Rezoluta IDI e vitit 2001). Sipas Komisionit Badinter (Opinion Nr 13), pretendimet që një shtet mund të ketë kundrejt një tjetri, sipas ligjit të përgjegjësisë së shtetit për dëmet e luftës ose shkeljet e tjera të ligjit ndërkombëtar, nuk janë direkt relevante për një ndarje të pasurive të shtetit, arkivave ose borxheve për qëllim të sukcesionit të shtetit. Por, Komisioni gjithashtu theksoi se nuk përjashton mundësinë e vendosjes së aseteve dhe detyrimeve që do të transferohen sipas rregullit të sukcesionit të shtetit kundër dëmeve të luftës. Kjo është potencialisht e rëndësishme për shpërndarjen në mes Serbisë dhe Kosovës, duke pasur parasysh shkeljet e ligjit ndërkombëtar humanitar kryer më parë nga RFJ/Serbia në Kosovë.

45. Ashtu si me KVSS e vitit 1978, dhe KVSS e vitit 1983 përmban disa dispozita specifike të zbatueshme për "Shtetet e reja të pavarura". Veçanërisht, Neni 38 parashikon që asnjë borxh shtetëror nuk duhet të kalojë tek shtetet e reja të pavarura derisa ka një marrëveshje në mes tyre, përndryshe parashikon lidhjen në mes të borxhit dhe aktivitetit në territorin e Shtetit të ri të pavarur. Siç diskutohet në paragrafët [32] deri [37], kategoria e shtetit të ri të pavarur kishte për qëllim të mbulojë ish kolonitë dhe është diskutabile nëse Kosova do të përfshihet në atë kategori.

46. Gatishmëria e Kosovës për të pranuar rekomandimet dhe detyrimet e përfshira në Planin e Ahtisaarit, siç pohohet në Deklaratën e saj të Pavarësisë, sugjeron se ajo është e gatshme të 'marrë përsipër pjesën e saj të borxhit ndërkombëtar të Republikës së Serbisë', natyra dhe madhësia e së cilës do të përcaktohet përmes negociatave në mes të Kosovës dhe Republikës së Serbisë, duke marrë parasysh 'parimet e përdorura për përcaktimin e borxhit sovran në rastin e sukcesionit të Republikës Socialiste Federale

të Jugosllavisë, në marrëveshje me kreditorët relevant' (Shtojca VI). Nëse palët nuk arrijnë marrëveshje për ndarjen e borxhit, Plani parashikon mbështetje për arbitrazhin detyrues ndërkombëtar.

47. Plani i Ahtisaarit përcakton më tej, dhe Kosova me sa duket ka rënë dakord, që të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të Republikës Federale të Jugosllavisë ose Republikës së Serbisë të vendosura brenda territorit të Kosovës në kohën e [Z]gjdhjes do t'i kalojnë Kosovës' (Neni 8). Në mënyrë të ngjashme, Plani parashikoi që ndërmarrjet në pronësi publike (NP) dhe detyrimet përkatëse do të transferoheshin në Kosovë (Shtojca VII).

Përfundime dhe rekomandime

48. Siç sugjeron analiza e mësipërme, Kosova mund të konsiderohet si një shtet pasardhës i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ), por më me besueshmëri mbase si një shtet pasardhës i Republikës së Serbisë, kjo e fundit një shtet vazhdues i Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ)/Unioni Shtetëror i Serbisë dhe Malit të Zi pas shpërbërjes së RSFJ-së. Ndërkohë që mund të argumentohet se Kosova duhet të konsiderohet si një shtet i ri i pavarur i dalur nga sundimi neokolonial i Serbisë, kjo linjë e argumentit kërkon pranimin e supozimeve në lidhje me natyrën e marrëdhënieve historike të Serbisë me Kosovën që nuk janë gjerësisht të akceptueshme midis shteteve.

49. Sukcesioni i shteteve është një fushë komplekse dhe e diskutueshme e së drejtës ndërkombëtare. Është e rregulluar pjesërisht nga dy konventa ndërkombëtare (Konventa e Vjenës në Sukcesionin e Shteteve në lidhje me Traktatet e vitit 1978 dhe Konventa e Vjenës në Sukcesionin e Shteteve në lidhje me Pronën, Arkivat dhe Borxhet shtetërore). Megjithatë, asnjëra nga Konventat nuk ka qenë e ratifikuar gjerësisht. Sukcesioni i shteteve është kështu një çështje e rregulluar kryesisht nga e

drejta ndërkombëtare zakonore, por ka mosmarrëveshje të konsiderueshme midis shteteve në lidhje me përmbajtjen e ligjit përkatës zakonor.

50. Është e paqartë nëse ekziston një rregull i përgjithshëm në favor të suksesionit automatik në lidhje me traktatet. Tendenca mbizotëruese ka qenë përkrahëse e supozimit se traktatet vazhdojnë të zbatohen në shtetet suksesore dhe kështu do të zbatohen te Kosova, por kjo pikëpamje nuk është e pakundërshtueshme. Impikimi i statusit të Kosovës në mes të viteve 1999 dhe 2008, kur ishte nën administrimin e Kombeve të Bashkuara do të thotë se Kosova nuk mund të obligohet/lidhet nga detyrimet e marra përsipër nga RFJ/Unioni Shtetëror/Serbia në mes të periudhës kohore 10 qershor 1999 dhe 17 shkurt 2008, por vetëm nga ato detyrime të marra nga Kombet e Bashkuara. Në të vërtetë, Kosova merr pikëpamjen, siç pasqyrohet në Deklaratën e Pavarësisë, se i pranon vetëm detyrimet e traktatit që hyjnë nga RSFJ dhe nga Kombet e Bashkuara.

51. Rregullat e Konventës të zbatueshme te suksesioni i shtetit në lidhje me pronën, borxhet dhe arkivat shtetërore janë kryesisht të natyrës së përgjithshme. Prandaj, ashtu si me traktatet, këto aspekte të suksesionit rregullohen edhe nga e drejta zakonore, megjithatë, nuk është e specifikuar plotësisht. Plani i Ahtisaarit përmban rekomandime të detajuara sa i përket ndarjes së barabartë të pronave dhe borxheve shtetërore të cilat Kosova i ka përfshirë në Deklaratën e saj të Pavarësisë dhe që është e gatshme t'i pranojë.

52. Me supozimin se Kosova është një shtet suksesor i Republikës së Serbisë, por duke pasur parasysh implikimet e statusit të Kosovës në mes të viteve 1999 dhe 2008 siç u diskutua më lart, rekomandohen veprimet e mëposhtme nga ana e Kosovës:

- Kosova duhet të lëshojë një deklaratë të re të gjerë dhe të përgjithshme¹ për pranimin ndaj detyrimeve të traktatit ndërkombëtar të shtetit të saj paraardhës;

¹Kosova ka bërë tashmë një deklaratë të tillë me Deklaratën e Pavarësisë së saj.

- Kosova duhet të vazhdojë të kërkojë të negociojë marrëveshje që konfirmojnë zbatueshmërinë e vazhdueshme të traktateve dypalëshe në Kosovë të lidhura me shtetin e saj paraardhës;
- Kosova duhet të kërkojë të arrijë, përmes negociatave dhe marrëveshjes me Serbinë, një ndarje të barabartë të pronave dhe borxheve;
- Nëse marrëveshja me Serbinë për ndarjen e pronave dhe borxheve shtetërore nuk mund të arrihet, Kosova duhet të kërkojë zgjidhje përmes arbitrazhit;
- Në pajtim me Rezolutën 9 (1946) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të 15 tetorit 1946, i cili parashikon kushtet në të cilat Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë do të jetë e hapur për shtetet jo palë në Statutin e GJND-së, Kosova duhet të depozitohet në Regjistrin e Gjykatës një deklaratë me të cilën pranon juridiksionin e Gjykatës dhe merr përsipër të zbatohet në mirëbesim vendimet e Gjykatës dhe të pranojë të gjitha detyrimet e një anëtarit të Kombeve të Bashkuara sipas Nenit 94 të Kartës. Një deklaratë e tillë, që mund të jetë ose e veçantë (në lidhje me një mosmarrëveshje apo disa mosmarrëveshje që janë ngritur) ose e përgjithshme (në lidhje me të gjitha mosmarrëveshjet ose të një apo disa klasave të mosmarrëveshjeve të cilat janë ngritur tashmë ose të cilat mund të ngrihen në të ardhmen), është një kërkesë për shtetet jo palë të Statutit të kenë qasje në Gjykatë— një kërkesë e cila, nëse përmbushet, në parim mund të lejojë Kosovën të ketë qasje në Gjykatë për të zgjidhur mosmarrëveshjet me Serbinë në lidhje me çështje të suksesionit;
- Kosova duhet në mënyrë të kujdesshme të vazhdojë të kërkojë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, në bazë të së cilës pohon/afirmon statusin e saj si shtet suksesor.

